

**VENDIM****Nr. 627, datë 29.7.2020****PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË BILETAVE TË TEATRIT KOMBËTAR  
TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e tarifës së biletave për Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  2. Miratimin e masës së reduktimit në tarifat epërcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Masa e reduktimit nuk aplikohet për biletat e premierave.
  3. Të ardhurat e realizuara nga shitja e biletave të përdoren:
    - a) 30% për llogari të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, sipas limitit të përcaktuar në planin e shpenzimeve;
    - b) 70% derdhen në buxhetin e shtetit.
  4. Në asnjë rast, këto të ardhura nuk do të përdoren për shpërblimin e punonjësve.
  5. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR  
**Erion Braçe**

**SHTOJCA NR. 1**  
**ÇMIMET E BILETAVE TË TEATRIT KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE**  
**ANSAMBLIT POPULLOR**

Kategoria	Vendndodhja në auditorium	Kapaciteti	Opera/ gala/ musical		Balet/ opereta		Shfaqje ekskluzive/ koncerte	
			premierë	repertor	premierë	repertor	premierë	repertor
A	Lozhat qendrore	32	2,500	2,000	2,000	1,500	1,500	1,000
B	Plateja 7–16	320	2,000	1,500	1,200	1,000	1,000	800
	Lozhat anësore	16	2,000	1,500	1,200	1,000	1,000	800
C	Plateja 1–6	190	1,200	1,000	1,000	800	800	500
	Galeria	242	1,200	1,000	1,000	800	800	500
	Holli, kati II	100					500	500
Teatri për fëmijë			500		400		300	

**SHTOJCA NR. 2**  
**REDUKTIMET E BILETAVE BAZUAR NË KATEGORITË SOCIALE**

Kategoria	Masa e reduktimit në %, në raport me tarifat bazë të biletave
Pensionistët	25%
Invalidët e punës	50%
Paraplegjik/tetraplegjik	50%
Jetimët	50%
Studentët	50%
Fëmijë (mosha 6–18 vjeç)	50%
Të verbrit	100% (hyrja falas)